



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit

S- 025

Prishtinë, më 11 qershor 2008, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
11 QERSHOR 2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit.

Të gjithë anëtarët e Kryesisë ishin të ulur në binën e sallës së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 98 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në konsultim me kryetarët e grupeve parlamentare, me propozimin e Presidentit dhe të Kryeministrit të Kosovës, ka thirrur seancën e sotme plenare me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Himnit shtetëror të Republikës së Kosovës

Kryetari informoi deputetët se konkursi për Himnin e Republikës së Kosovës ishte shpallur më 12 mars 2008.

Kriteret që është dashur t'i plotësojnë propozuesit për Himnin e Republikës së Kosovës kanë qenë, si vijon:

1. Kompozimi të jetë i dallueshëm, unik dhe origjinal,
2. Kompozimi mos të jetë më i shkurtër se 30 sekonda dhe më i gjatë se 60 sekonda,
3. Propozimet t'i përmbahen frymës së Dokumentit gjithëpërfshirës për statusin politik të Kosovës, dhe
4. Himni nuk duhet të përngjajë me asnjë himn ose këngë popullore të asnjë vendi tjetër.

Komisionit për përzgjedhjen e Himnit i kishin arritur 134 propozime – 110 nga Kosova dhe 24 nga vende të tjera.

Komisioni për përzgjedhjen e Himnit ishte në këtë përbërje:

1. Hajredin Kuçi, kryetar,
2. Nekibe Kelmendi, nënkryetare,
3. Arsim Bajrami, anëtar,
4. Ramë Manaj, anëtar,
5. Mahir Yagcillar, anëtar,
6. Fadil Ferati, anëtar,
7. Bujar Dugolli, anëtar,
8. Esat Brajshori, anëtar,
9. Berim Ramosaj, anëtar,
10. Ilir Bajri, anëtar,
11. Baki Jashari, anëtar, dhe
12. Slllobodan Petroviq, anëtar.

Komisioni ka përzgjedhur 3 propozime:

1. Numrin 80, me kodin “Evropa”,
2. Numrin 28, pa kod, dhe
3. Numrin 07, me kodin 2751.

Kryesia e Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare, me propozimin e Presidentit dhe të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, kanë mbajtur mbledhje të përbashkët, më 4 qershor 2008, në të cilën janë prezantuar rezultatet e konkursit nga ana e Komisionit për Himnin e Republikës së Kosovës. Në këtë mbledhje është vendosur që rezultatet e konkursit, të përzgjedhura nga Komisioni për Himnin, t'iu prezantohen grupeve parlamentare dhe që ato të përcaktohen për njërin nga variantet e propozuara.

Grupet parlamentare Kuvendit i kanë rekomanduar ta miratojë propozimin me numër 80, kodi “Evropa”.

Në vazhdim, Kryetari tha se Kuvendi brenda një periudhe të shkurtër shpalli Pavarësinë e Kosovës shtet të pavarur, sovran dhe demokratik; miratoi Flamurin dhe stemën e shtetit; miratoi Kushtetutën e Kosovës, dhe sot, me miratimin e Himnit të Kosovës, po i rumbullakojmë simbolet e Republikës së Kosovës, shtet të pavarur dhe sovran, që dalin nga Pakoja

gjithëpërfshirëse për statusin politik të Kosovës, dhe po përgatitemi që pas 15 qershorit 2008, institucionet e Kosovës t'i marrin të gjitha përgjegjësitë që i kanë me Kushtetutën e re të Republikës së Kosovës.

Kryetari kërkoi nga regjia që ta emitojë Himnin me numër 80, kodi “Evropa”, të cilin e dëgjuan të gjithë deputetët.

Kryetari, pas intonimit të Himnit me numër 80, kodi “Evropa”, kërkoi nga grupet parlamentare që të deklarohen lidhur me himnin e propozuar.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se mbështesin miratimin e propozimit numër 1, me kodin “Evropa”.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se mbështesin miratimin e propozimit numër 1, me kodin “Evropa”.

Behxhet Pacolli, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deklaroi se kanë hezitime lidhur me propozimin numër 1, me kodin “Evropa”, të cilin ai personalisht e përkrah, por deputetët e këtij grupi le të votojnë secili sipas bindjes së tij.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se mbështesin miratimin e propozimit numër 1, me kodin “Evropa”.

Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se nuk është i kënaqur me përzgjedhjen e alternativave të ofruara, por duke pasur parasysh proceset, ne do të marrim pjesë në procesin e votimit dhe secili deputet do të vendos sipas vullnetit të vet.

Zylfi Merxha, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, tha se mbështesin miratimin e propozimit numër 1, me kodin “Evropa”.

Pas këtyre deklarimeve, **Kryetari** ftoi deputetët që me votim – ngritje dore- të deklarohen për propozimin e Himnit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 72,
Kundër-----15,
Abstenime-----5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Himnin shtetëror të Republikës së Kosovës.

Në fund, **Kryetari** kërkoi që të intonohet Himni shtetëror i Republikës së Kosovës dhe të gjithë deputetët e Kuvendit u ngritën në këmbë dhe dëgjuan himnin.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 11:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale